



BULETINI MUJOR

Prill
2026



Në kuadër të Ditës Botërore të Autizmit u zhvillua në pedonalen e qytetit të Beratit aktiviteti “PAK Art në pedonale”, një panair i punimeve të fëmijëve që marrin shërbime në dy qendrat e zhvillimit të qytetit të Beratit dhe në qendrën multifunksionale Dimal.

Me praninë e Zv/Kryeministres, znj. Albana Koçiu, Ministres së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale znj. Evis Sala, Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, z. Ervin Demo, lançuan Planin Kombëtar të PAK 2026–2030.

Për herë të parë, pagesat mujore për fëmijët me aftësi të kufizuara do të dyfishohen, duke ofruar një mbështetje më të madhe financiare për plotësimin e nevojave të tyre. Gjithashtu, për herë të parë do të njihen kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për kujdestarët/ndihmësit e tyre, duke vlerësuar rolin e rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm që ata luajnë në përkujdesjen e përditshme.



Më 29.04.2026 u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe Shërbimit Social Shtetëror, duke shënuar një hap të rëndësishëm në forcimin e mekanizmave të mbështetjes sociale në vend. Marrëveshja parashikon vënien në dispozicion të aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara për institucionet dhe organizatat që ofrojnë shërbime sociale.

Ky bashkëpunim synon të përmirësojë koordinimin ndërinstitucional dhe të krijojë një model më efikas të përdorimit të këtyre aseteve në funksion të interesit qytetar dhe mbështetjes së grupeve më vulnerabël. Në këtë kuadër, Shërbimi Social Shtetëror luan një rol kyç si urë lidhëse mes institucioneve publike dhe organizatave jofitimprurëse, duke garantuar që shpërndarja e aseteve të jetë e drejtë dhe në përputhje me nevojat reale të komunitetit.



SHËRBIMI SOCIAL

Shërbimi Social Shtetëror

📍 Rruga e Durrësit, nr. 83, Tiranë, Shqipëri

☎ 044 54 18 21

✉ info@sherbimisocial.gov.al

🌐 www.sherbimisocial.gov.al